



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 98 Prot.

Tiranë, më datë 04.02.2021

VENDIM
Nr. 25, datë 04.02.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale” dhe Urdhrit Nr.223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 04.02.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Restaurimi i çatisë Sarajet e Beut Libohovë”, Libohovë, me projektues DRTK Gjirokastrë;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

